



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 paragrafi _ në lidhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar pas denoncimit, në vazhdimin e senacës së 46-të të mbajtur me datë 12.02.2021, morri

VENDIM

Duke vepruar për lëndën me numër 09-5041/1 me datë 01.11.2019 e formuar me iniciativë të veten në përputhje me nenin 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, në bazë të evidencës në Deklaratat për interesa në përputhje me kompetencat e Komisionit shtetëror të parapara në neni 17 paragrafi 12 nga ligji i njëjtë, është konstatuar gjendje e konfliktit të interesave, tek personi i punësuar në komunë në vendin e punës kafe-bërës dhe anëtar i Këshillit të komusë së njëjtë. Gjendja e krijuar është në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe nenin 44 paragrafi 3 nga Ligji për vetqeverisje lokale.

SQARIM

Në deklaratën për interesa dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit personi ka theksuar se është zgjedhur për anëtar të Këshillit të Komunës dhe se është i punësuar në komunën e njëjtë.

Me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike, por duke pasë parasysh se gjendja e atillë është në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe nenin 44 paragrafi 3 nga Ligji për vetqeverisje lokale, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek Kryetari i komunës së dhe deri tek ai dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve për atë se vallë personi është i punësuar në komunën e

Në afatin e caktuar me ligj, Komuna e e ka informuar Komisionin shtetëror se anëtar i zgjedhjeve lokale nga viti 2017 është bërë anëtar i Këshillit të Komunës dhe mandati i është verifikuar me datë 30.07.2017 nga Këshilli i komunës

Personi është edhe i punësuar në Komunën e Pertovecit në vendin e punës kafe-bërës – pastrues nga 07.07.2014 me shpallje të konkursit publik dhe se pas zgjedhjes si anëtar i Këshillit të Komunës, marrëdhënja e punës nuk i është pushuar (nuk është ndërprerë). Në shtojcë të përgjigjes është dorëzuar edhe vendimi për shpërndarje të vendeve të punës me numër 04-1066 me datë 07.07.2014.

Gjatë kësaj gjenje faktike të caktuar, Komisioni shtetëror deri tek dorëzoi informim dhe kërkesë për veprim me të cilën tregohet se gjendejn në konflikt të interesave, gjegjësisht është në situatë e cila është në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe nenin 44 paragrafi 3 nga Ligji për vetqeverisje lokale dhe nga ajo kërkon që në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të informimi

të ndërmerr veprime në drejtim të menjanimit të gjendjes së krijuar që do të lë në qetësi marrëdhënjen e punës në komunë ose do të largohet nga funksioni si anëtar në Këshillin e komunës

Neni 44 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave

(7) Personit zyrtar që është punësuar në administratën lokale, nëse zgjedhet për anëtar të këshillit të komunës, gjegjësisht qytetit të Shkupit marrëdhënja e punës i pushon (në qetësi) në përputhje me ligjin, në ditën e verifikimit të mandatit për anëtar të këshillit.

Neni 44 nga Ligji për vetqeverisje lokale

(4) Anëtari i këshillit, nuk mund të jetë i punësuar në administratën e komunës në komunën ku është i zgjedhur

Përveç kësaj, Komisioni shtetëro dorëzoi informim dhe kërkesë për veprim edhe deri tek Inspektorati shtetëror për vetqeverisje lokale me të cilën i informon inspektorët për gjendjen në komunën e dhe duke pasë parasysh se nuk janë respektuar dispozitat ligjore dhe ndalesat e shqiptuara të caktuara në Ligjin për vetqeverisje lokale, nga ai kërkon të vepron në përputhje me kompetencat e veta dhe ingjencat përshkak të vërtetimit të përgjegjësisë së rastin konkret, kurse për veprimet e ndërmarra ta informon Komisionin shtetëror.

Me datë 02.03.2020 personi e informoi KSHPK se ka dorëzuar kërkesë deri tek Kryetari i komunës që ta pushon marrëdhënjen e punës, pas të cilës vetëmse është vepruar me miratimin e aktvendimit për pushim të marrëdhënjes së punës me datë 28.02.2020 dhe e cila është realizuar nga Agjensioni për punësim.

Përshkak të asaj që brenda afatit të paraparë me ligj, Inspektorati shtetëror për vetqeverisje lokale nuk e ka informuar Komisionin shtetëror në lidhje me dorëzimin e informimit dhe kërkesën për veprim, deri tek Inspektorati ka dorëzuar Urgjencë që të shprehen për veprimin.

Pas dorëzimit të urgjencës, Inspektorati për vetqeverisje lokale e ka informuar Komisionin shtetëror se në përputhje me kërkesën e Komisionit është bërë inspektim i jashtëzakonshëm në hapsirat e komunës së, gjatë së cilës ka pasur takim me Kryetarin e komunës dhe sekretarin e komunës së

OPërshkak se bëhet fjalë për lëndë, gjegjësisht rregulla të komunës që janë miratuar në vitin 2017, me kërkesë të përfaqësuesit të komunës i cili ka marrë pjesë në inspektimin e jashtëzakonshëm, iu është dhënë afat prej 8 ditë për dorëzim të dokumentacionit të plotë të kërkuar dhe e njëjta brenda afatit është pranuar në Inspektoratin, dhe atë:

- Statusi i komunës
- Rregullorja e Këshillit të komunës
- Vendimi për verifikim të mandatit të këshilltarëve në Këshillin e komunës
- Kërkesë nga dorëzuar deri tek Kryetari i komunës
- Aktvendim për pushim të marrëdhënjes së punës
- Regjistrim/çregjistrim për të emëruarin

Nga faktet e inspektimit të bërë, si dhe nga analiza e dokumentacionit të kërkuar, me datë 10.08.2020 Inspektorati shtetëror për vetqeverisje lokale e informoi KSHPK se është bërë inspektim i jashtëzakonshëm dhe është konstatuar se personi i përmendur dhe Kryetari i komunës së vetëmse kanë vepruar për kërkesën e KSHPK për menjanim të gjendjes së konfliktit të interesave.

Nga kjo gjendje faktike e caktur, Komisioni shtetëror në senacën e 46-të në rastin konkret ka konstatuar shkelje të nenin 44 paragrafi 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe nenin 44 paragrafi 3 nga Ligji për vetqeverisje lokale.

Personi me datë 31.02.2020 ka qenë në situatë të konfliktit të interesave dhe ka marrë rrogë si i punësuar në administratën e komunës dhe kompenzim si anëtar i Këshillit të komunës në përputhje me nenin 29-a dhe nenin 29-b paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për rroga dhe kompenzime tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të zgjedhurve tjerë dhe personave të emëruar në Republikë (Gazeta zyrtare e RMV, nr 36/1990, 44/1990, 11/1991 dhe 38/1991 dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numrë 23/1997, 37/2005, 84/2005, 121/2007, 161/2008, 92/2009, 42/2010, 97/2010, 162/2010, 11/2012, 145/2012, 170/2013, 139/2014 dhe 233/2018).

Komisioni shtetëror konstaton se gjendja e konfliktit të interesave është e larguar mirëpo kjo gjendje i ka shkaktuar dëme materialëe buxhetit të komunës dhe përshkak të asaj vendosi që deri tek Prokuroi themelore publike - Shkup të parashtron iniciativë për vërtetim të përgjegjësisë penale kundër Kryetari të Komunës së përshkak se të njëjtit si person përgjegjës në komunë kan qenë i informuar për këtë gjendje dhe nuk ka ndërmarrë asgjë për pengimin e asaj, gjegjësisht si person zyrtar e ka shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare ose autorizimin, kurse me tejaklim të kufive të autorizimeve të veta zyrtare ose me mosekzekutimin e detyrës së vet zyrtare ka mundësuar fitim të ndonjë interesi për tjerë në përputhje me nenin 353 nga Kodi penal.

Duke pasë parasyshë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dipozitive të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ**
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Përpunoi: m-r Ema Neshkoska, bashkëpunorë
Miratoi: Nuri Bajrami, anëtar i KSHPK